

# Menaxhimi i Mbetjeve dhe Mbrojtja Mjedisore Bashkëpunimi Ndërkufitar IPA, Shqipëri-Kosovë

## Konteksti

Bashkitë përfaqësuese të bashkëpunimit ndërkufitar të rajonit të Kosovës dhe Shqipërisë shtrihen në basenin e Drinit, duke përfshirë lumenjtë më të gjatë në Shqipëri (Drini Zi) dhe Kosovë (Drini Bardhë). Lumi Drin është një burim ujorë i rëndësishëm si përdiversitetin ekologjik dhe për benefitet e tij ekonomike, ndërkohë që furnizon dhe tre hidrocentralet më të mëdha të Shqipërisë, Fierzën, Vaun e Dejës, dhe Komanin.

Potencialet e eko-turizmit e luginës së lumit Drin, janë penguar gjithmonë nga ndotja e mbetjeve të riciklueshme, duke shkaktuar ndotjen dhe funksionimin efiçent të rrjedhjeve të hidrocentraleve. Për këtë arsye fokusi është vendosur në menaxhimin e integruar të mbetjeve për të mbrojtur ekosistemin e Drinit dhe për të stimuluar zhvillimin ekonomik nëpërmjet mbledhjes dhe riciklimit të mbetjeve.

## Qëllimi

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxis zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjen mjedisore nëpërmjet promovimit të riciklimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve në kuadrin e bashkëpunimit rajonal ndërkufitar, duke rritur ndërgjegjësimin dhe nivelin e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve.

Fokusi kryesorë i projektit do të jetë mbrojtja mjedisore dhe zhvillimi ekonomik nëpërmjet promovimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve përmes edukimit, trajnimit dhe aktiviteteve në përfitimet nga riciklimi.



## Objektivat Specifike

Objektivi specifik i projektit është të rris njohuritë dhe angazhimin e 5000 studentëve, 300 mësuesve dhe 1000 qytetarëve në rajon në benefitet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe riciklimin për mbrojtjen mjedisore dhe zhvillimin ekonomik.

Mungesa e ndërgjegjësimin, edukimit dhe aktivitetit në mesin e qytetarëve mbi çështjet mjedisore ka qenë determinuese mbi normat e sjelljes dhe kushtet mjedisore dhe sociale.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje sfidat mjedisore dhe sociale shndërrohen në oportunitet ekonomike. Duke rritur nivelin e njohurive, angazhimit dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve mbi menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe riciklimin, shoqëria kosovare dhe shqiptare i mundësohet përshpejtimi në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

## Rezultatet

Këto objektiva kontribuojnë në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe janë në linjë me ligjet dhe strategjitë e aprovuara në nivelet lokale dhe kombëtare në Kosovë dhe Shqipëri, dhe kanë mbështetjen e aktorëve kyç të cilët janë thelbësor për integrimin në BE. Ligjet e

Kosovës mbi Menaxhimin e Mbetjeve rekomandojnë edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimin në mbrojtjen mjedisore.

## FAKTET KRYESORE

### DONATOR:

- ✓ Komisioni Europian

### PARTNERË:

- ✓ IKU (Shqipëri)
- ✓ Bashkia Kukës
- ✓ ATRC (Kosova)
- ✓ Bashkia Prizren (Kosova)

### KOHËZGJATJA:

- ✓ Shtator 2014 - Mars 2016

### PËRFITUES:

- ✓ Bashkia Kukës
- ✓ Bashkia Prizren

### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane  
Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: uri@uri.org.al  
Web: www.uri.org.al

### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.